R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2129/2 prot. Tiranë, më 26.10.2026

V E N D I M

Nr. 44, datë 26.10.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikave 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar,

KONSTATOHET SE:

Ankuesi, z. (në vijim "ankuesi") ka paraqitur pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") tri ankesa, të regjistruara me nr. 1852 prot., datë 03.07.2026, nr. 1850 prot., datë 03.07.2026; dhe nr. 2129 prot., datë 29.07.2026, kundër Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (në vijim "AZHT" ose "Autoriteti Publik"), me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare". Duke qenë se ankesat janë paraqitur nga i njëjti ankues, kundër të njëjtit autoritet publik, dhe lidhen me dokumentacionin e të njëjtit projekt zhvillimor, Komisioneri ka vlerësuar shqyrtimin e tyre të përbashkët, duke ruajtur vlerësimin e veçantë të objektit të secilës ankesë.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, me kërkesën e datës 15.06.2026, depozituar në adresën elektronike info@azht.gov.al, ankuesi ka kërkuar kopje të vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit (në vijim "KKT"), konkretisht: *(i) vendimi nr. 19, datë 25.09.2024; (ii) leje zhvillimi për objektin resort turistik me vendndodhje në Zvërnec, Bashkia Vlorë, me subjekt "Zvërnec South Adriatic Development", si dhe materialet e plota të dosjes së paraqitur nga subjekti zhvillues; (iii) vendimi nr. 9, datë 04.10.2024; (iv) leje zhvillimi për objektin resort turistik me vendndodhje në Zvërnec, Bashkia Vlorë, me subjekt "Zvërnec South Adriatic Development", shfuqizuar me vendimin nr. 12, datë 18.04.2025, si dhe materialet e plota të dosjes së paraqitur nga subjekti zhvillues; (v) vendimi nr. 39, datë 25.01.2025; (vi) leje zhvillimi për objekt gadishullin e Zvërnecit, blloku rezidencial, si dhe kopje të deklaratës së dorëheqjes së subjektit.*

Autoriteti Publik, nëpërmjet *email*-it të datës 01.07.2026, i ka kthyer përgjigje kërkuesit, duke e informuar se në lidhje me vendimmarrjet e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit (në vijim "KKTU") mbi projekt-propozimin e "Zvërnec Peninsula", Këshilli Kombëtar i Territorit ka marrë vendimet e mëposhtme:

1. Me Vendimin nr. 19, datë 25.09.2024, ka vendosur refuzimin e kërkesës për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin "Resort Turistik, me vendndodhje në Zvërnec, Bashkia Vlorë", me subjekt zhvillues shoqërinë "Zvërnec South Adriatic Development" sh.p.k.

2. Me Vendimin nr. 09, datë 04.10.2024 ka miratuar lejen e zhvillimit për objektin "Resort Turistik, me vendndodhje në Zvërnec, Bashkia Vlorë", me subjekt zhvillues shoqërinë "Zvërnec South Adriatic Development" sh.p.k., vendimmarrje e cila është shfuqizuar me Vendimin nr. 12, datë 18.04.2025.

3. Me Vendimin nr. 39, datë 28.01.2025, ka miratuar lejen e ndërtimit për objektin "Resort turistik në Gadishullin e Zvërnecit, Blloku Rezidencial F1V2, F1V3, F1R6, me vendndodhje në Pishë Poro-Nartë, Bashkia Vlorë", me subjekt zhvillues shoqërinë "Zvërnec South Adriatic Development" sh.p.k., vendimmarrje e cila nuk është më në fuqi, pasi subjekti zhvillues ka depozituar pranë institucionit tonë kërkesë, nëpërmjet së cilës është tërhequr aplikimi i sipërcituar.

4. Me Vendimin nr. 12, datë 18.04.2025, ka miratuar lejen e zhvillimit për objektin "Resort turistik, me vendndodhje në Zvërnec, Bashkia Vlorë," me subjekt zhvillues shoqërinë "Zvërnec South Adriatic Development" sh.p.k., me anë të të cilit shfuqizohet Vendimi nr. 09, datë 04.10.2024, i KKT-së, por edhe kjo vendimmarrje është shfuqizuar me Vendimin nr. 41, datë 30.03.2026.

Aktualisht në fuqi janë vetëm vendimmarrjet e mëposhtme:

1. Vendimi nr. 41, datë 30.03.2026, për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin "Zvërnec Peninsula - Kompleks multifunksional, banimi, shërbimesh, hotelerie, rekreacion, marina, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 kate, me vendndodhje në Zvërnec, Bashkia Vlorë", me subjekt zhvillues shoqërinë "Zvërnec South Adriatic Development" sh.p.k., me anë të të cilit shfuqizohet Vendimi nr. 12, datë 18.04.2025, i KKT-së.

2. Vendimi nr. 05, datë 29.04.2026, për miratimin e Leje Ndërtimi Infrastrukture për objektin "Për kryerjen e punimeve të rrethimit dhe të punimeve përgatitore në funksion të ndërtimit të rrugëve të aksesit brenda pronës", me subjekt zhvillues shoqërinë "Zvërnec South Adriatic Development" sh.p.k.

Po në të njëjtën përgjigje, Autoriteti Publik ka parashtruar se: *"Në lidhje me vendimmarrjet e sipërcituara, të cilat janë në fuqi, ju bëjmë me dije se, vetëm pas plotësimit të të gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor nga ana e subjektit zhvillues, institucioni jonë do të vijojë me procedurat e zbardhjes së vendimeve të sipërcituara, të cilat pas nënshkrimit nga Kryetari i KKTU-së, Ministrit të Linjës, si dhe Sekretari i KKTU-së, do të mund t'i aksesoni në faqen zyrtare web të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit www.azht.gov.al, në rubrikën "Vendime KKT"... në fuqi është Leje Ndërtimi Infrastrukture, e konkretisht Vendimi nr. 05, datë 29.04.2026, e cila konsiston në rrethimin perimetral të pasurive objekt zhvillimi, realizimin e rrugëkalimeve të nevojshme*

për vendosjen e pajisjeve të përkohshme që do të përdoren për studimin e biodiversitetit, ujit dhe lagunës".

Me kërkesën e datës 19.06.2026, depozituar në adresat elektronike info@azht.gov.al dhe @azht.gov.al, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion kopje e plotë e procesverbalit të mbledhjes së KKTU-së, të datës 29.04.2026.

Nëpërmjet *email*-it të datës 01.07.2026, Autoriteti Publik i ka kthyer përgjigje ankuesit duke i sqaruar se procesverbalet e mbledhjeve të KKTU-së nuk përbëjnë akte administrative në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative, pasi ato nuk krijojnë, ndryshojnë apo shuajnë të drejta dhe detyrime për subjektet e interesuara. Aktet që prodhojnë pasoja juridike janë vendimet përfundimtare të KKTU-së, të cilat miratohen dhe publikohen sipas legjislacionit në fuqi, në faqen zyrtare të AZHT-së, në rubrikën "Vendime KKT". Gjithashtu, Autoriteti Publik, në përgjigjen e tij, ka sqaruar kërkuesin se informacionin mbi lejet e shqyrtuara nga KKTU mund ta aksesonte në rubrikën "Njoftimet e fundit", në faqen *web* www.azht.gov.al, në të cilën gjendeshin edhe rendet e ditës për çdo mbledhje, duke garantuar transparencën mbi çështjet e trajtuara dhe vendimmarrjet e Këshillit.

Ankuesi, me anë të kërkesës së datës 14.07.2026, depozituar në adresën elektronike info@azht.gov.al, ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion kopje e projektit "*Zvërnec Peninsula - Kompleks multifunksional, banimi, shërbimesh, hotelerie, rekreacion, marina, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 kate, me vendndodhje në Zvërnec, Bashkia Vlorë", me subjekt zhvillues shoqërinë "Zvërnec South Adriatic Development" sh.p.k.*". Në lidhje me këtë kërkesë, nga aktet rezultoi se Autoriteti Publik nuk ka kthyer përgjigje.

Në vijim, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit tri ankesat e përshkruara më sipër, duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në ankesat e sipërpërshkruara, vlerësoi se ato përmbushin kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Komisioneri, nëpërmjet shkresave nr. 1852/1 prot., datë 10.07.2026, nr. 1850/1 prot., datë 10.07.2026 dhe nr. 2129/1 prot., datë 06.08.2026, drejtuar Autoritetit Publik dhe për dijeni ankuesit, ka kërkuar të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Në mungesë të një përgjigjeje nga Autoriteti Publik ndaj shkresave të Komisionerit, të sipërcituara, gjatë shqyrtimit administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI-së, në të cilin parashikohet se: "...*me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*", bazuar edhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", me shkresat nr. 1850/2 prot., datë 23.07.2026 dhe nr. 1852/2 prot., datë 23.07.2026, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Seanca u zhvillua me prezencën e ankuesit dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi, z. , rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesat e tij. Ndërsa, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, znj. , në cilësinë e përgjegjësit pranë Drejtorisë Juridike dhe Shqyrtimit të Aplikimeve, dhe znj. , në cilësinë e koordinatorit të së Drejtës për Informim, kërkuan kohë për të rivlerësuar qëndrimin e Autoritetit Publik.

Ndonëse me dakordësinë e ankuesit përfaqësuesit e Autoritetit Publik morën përsipër në seancë të rivlerësonin qëndrimin e tyre, pas kalimit të afatit të kërkuar (1 javë) nuk rezultoi t'i kenë kthyer përgjigje kërkuesit.

Në eventualitetin e këtyre fakteve, pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë shqyrtimit administrativ të çështjes, Komisioneri vëren se për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI në nenin 1 ka përcaktuar se: *"Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike"*. Ndërkohë, në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 2 të LDI-së parashikohet se: *""Autoritet publik": a) është çdo organ publik, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj"*. Në kuptim të këtij parashikimi, Agjencia e Zhvillimit të Territorit është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI-së, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Gjithashtu, Komisioneri çmon të sjellë në vëmendje përcaktimin në pikën 3 të nenit 3 të LDI-së, e cila parashikon se: *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit"*.

Në interpretim të kësaj dispozite, çmohet se çdo person i interesuar ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, përmbajtja e të cilave reflekton veprimtarinë e organeve shtetërore dhe kërkesa për informim aktivizon detyrimin e Autoritetit Publik për të dhënë informacionin e kërkuar, përveç rasteve kur vetë ligji parashikon ndryshe.

Në këtë kontekst, në përputhje me nenin 3, pika 1, të LDI-së, çdo person gëzon të drejtën për të kërkuar informacion publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet e kërkesës apo të provojë një interes të veçantë. Për rrjedhojë, ankuesi legjitimohet të kërkojë informacionin objekt shqyrtimi, ndërsa vënia e tij në dispozicion i nënshtrohet vetëm kufizimeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, veçanërisht nga neni 17 i LDI-së.

Gjithashtu, LDI ka përcaktuar se, në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të përcaktuara në nenin 15, ose brenda afateve të përcaktuara në ligje të posaçme, do të konsiderohet refuzim.

Duke iu rikthyer rrethanave të faktit, Zyra e Komisionerit, në analizë të akteve e provave shkresore të administruara gjatë shqyrtimit administrativ të çështjes, si dhe kuadrit ligjor rregullator, vëren se informacioni i kërkuar përbën informacion publik, në përmbushje të kërkesave të pikës 2 të nenit 2 të LDI-së, ku parashikohet se: *""Informacion publik" është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik"*. Për rrjedhojë, procesverbalet, vendimet, deklaratat e tërheqjes dhe dokumentet e tjera të kërkuara, nëse administrohen nga AZHT, nuk përjashtohen nga fusha e së drejtës së informimit vetëm për shkak të natyrës së tyre procedurale ose teknike.

Sa më sipër, LDI nuk garanton të drejtën e informimit vetëm për atë kategori të informacionit publik që përbën akt administrativ në kuptim të Kodit të Procedurave Administrative. Përkundrazi, ai përmban një përkufizim joshterues dhe që duhet të interpretohet në mënyrë të gjerë. Kjo dispozitë përcakton se informacion publik përbën çdo e dhënë e regjistruar ku, përveç vendimeve apo akteve administrative, përfshihen akte normative, korrespondenca administrative, procesverbale, dokumente politikash, analiza, statistika etj., pavarësisht formës ose formatit të tyre, si tekste të shkruara, informacione të regjistruara në një kasetë zanore ose audiovizuale, fotografi, *email*-e, informacione të ruajtura në format elektronik, siç janë bazat e të dhënave elektronike etj.

Në këtë këndvështrim, argumenti i Autoritetit Publik se një pjesë e dokumentacionit të kërkuar nuk përbën akt administrativ përfundimtar, gjendet i pabazuar, pasi e drejta e informimit nuk kufizohet vetëm te akti që prodhon drejtpërdrejt pasoja juridike, por shtrihet edhe te dokumentacioni që ndihmon publikun të kuptojë bazën faktike, procedurën, kriteret dhe arsyetimin mbi të cilat mbështetet vendimmarrja publike.

Përkufizimi i sipërcituar nuk bën asnjë dallim as sa i përket destinacionit apo përdorimit të informacionit publik, qoftë ai për përdorim të brendshëm ose jo. Prandaj, si akti administrativ që i njoftohet të tretëve, akti që është i detyrueshëm për botim/publikim, apo akti i cili normalisht nuk publikohet në mënyrë proaktive nga institucioni, përveç rasteve kur kërkohet të merret përmes një kërkese për informacion, përbën informacion publik. Si pasojë, edhe procesverbali, si një prej kategorive të informacionit që prodhon apo administron një institucion, përbën informacion publik, sipas LDI-së.

Sa më lart, nuk vihet në diskutim fakti se procesverbali i KKTU-së, për shkak të përmbajtjes së tij dhe faktit se mbahet në kuadër të ushtrimit të funksionit publik, përbën informacion publik në kuptim të nenit 2, pika 2, të LDI-së. Çështja që kërkon zgjidhje lidhet me fazën procedurale në të cilën ndodhet ai dhe me faktin nëse në momentin e kërkesës vendimmarrja që ai pasqyron është formalizuar ose jo përfundimisht.

Megjithatë, në vlerësimin e rrethanave të faktit, Zyra e Komisionerit merr në konsideratë gjithashtu se, sipas informacionit publik të publikuar më 3 tetor 2026 nga Këshilli i Ministrave, portali "Flamingo Mirror/Pasqyra e Flamingos", si ndërfaqe e "Pasqyrë

Albania", është vënë në dispozicion të publikut dhe përmban dokumente zyrtare, referenca ligjore dhe informacion lidhur me dosjen Zvërnec/Sazan, përfshirë këtu edhe disa procesverbale të mbledhjeve të KKTU-se në lidhje me këtë dosje. Ky fakt është relevant për vlerësimin e aksesueshmërisë faktike të një pjese të informacionit të kërkuar.

Megjithatë, publikimi i një pjese të dokumentacionit në një portal ose në një platformë publike nuk e përjashton nga detyrimi AZHT-në për të trajtuar kërkesën dhe për të dhënë përgjigje të plotë lidhur me sa kërkohet. Për dokumentet që gjenden të publikuara dhe janë të aksesueshme pa pengesa, autoriteti duhet t'i referojë ankuesit linkun e saktë dhe titullin e dokumentit, duke i siguruar aksesin sipas ligjit, përveç rastit kur ekziston një kufizim i posaçëm, i arsyetuar dhe proporcional.

Gjithashtu, rrethana e prezantuar nga përfaqësuesit e Autoritetit Publik se disa prej vendimeve të kërkuara janë shfuqizuar, zëvendësuar, nuk përbën apriori shkak ligjor për refuzimin e aksesit në këto dokumente. Përkundrazi, dokumente të tilla mund të jenë të domosdoshme për të rindërtuar kronologjinë e vendimmarrjes, për të kuptuar ndryshimet ndërmjet akteve dhe për të ushtruar kontrollin publik mbi mënyrën e administrimit të kompetencave.

Po kështu, termi "zbardhje" apo fakti se një dokument është ende në proces nënshkrimi, formalizimi ose publikimi, nuk mund të përdoret si formulë e përgjithshme për të kufizuar aksesin në informacionin/dokumentacionin që Autoriteti Publik e zotëron. Autoriteti duhet të identifikojë konkretisht dokumentin, statusin e tij, nëse ekziston një kufizim ligjor i zbatueshëm dhe arsyet pse ky kufizim është i domosdoshëm. Nëse dokumenti përfundimtar nuk është zbardhur ende, kjo duhet të sqarohet shprehimisht. Ndërkohë, dokumentet ekzistuese që janë regjistruar ose administruar nuk mund të trajtohen sikur të mos ekzistonin.

Në rastin konkret, AZHT ka referuar numra dhe data të vendimmarrjeve, ka përshkruar përmbajtjen dhe efektet e tyre, si dhe ka konfirmuar depozitimin e një kërkese për tërheqje nga aplikimi. Këto deklarime përbëjnë tregues se ekzistojnë dokumente ose të dhëna të regjistruara, për të cilat duhet bërë vlerësim individual dhe i arsyetuar, jo refuzim në tërësi i kërkesës për informim. Në këtë optikë, çdo kufizim i së drejtës për informim duhet të kryhet në konsideratë të përcaktimit të pikës 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014, sipas të cilit nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit, pjesa tjetër duhet t'i vihet në dispozicion kërkuesit. Po ashtu, Autoriteti Publik duhet të identifikojë qartë pjesët e redaktuara ose të refuzuara dhe të tregojë bazën ligjore konkrete të kufizimit dhe jo të refuzojë në tërësi kërkesën për informacion. Pra, AZHT duhet të analizojë çdo dokument, të identifikojë elementet e mbrojtura nga informacioni administrativ, procedural dhe vendimmarrës, si dhe të vlerësojë nëse mundësohet akses i pjesshëm, përfshirë kopje me redaktime, ose një mënyrë tjetër e ligjshme aksesi.

Ky qëndrim i Komisionerit gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë*[1] vlerësoi se pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të

[1] *Kërkesa nr. 37374/05, vendim i datës 14.04.2009.*

dekurajojnë punonjësit e medias, ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e "mbikëqyrësit shoqëror", duke krijuar pengesa arbitrare për marrjen e informacionit që i shërben interesit publik. Zbatimi i jurisprudencës në këtë rast bëhet relevant veçanërisht për faktin se ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik.

Në një tjetër rast, në çështjen *Magyar Helsinki Bizottság kundër Hungarisë*[2], GJEDNJ ritheksoi rëndësinë e aksesit në informacion kur ai është instrument për ushtrimin e lirisë së shprehjes dhe kur informacioni kërkohet për të kontribuar në debat mbi çështje me interes të përgjithshëm. Gjykata, ndër të tjera, vlerësoi qëllimin e kërkesës, natyrën e informacionit dhe rolin e kërkuesit në përhapjen e tij, si dhe ekzistencën dhe disponueshmërinë e informacionit të kërkuar. Gjithashtu, në çështjen *Youth Initiative for Human Rights kundër Serbisë*[3], GJEDNJ konfirmoi rëndësinë e rolit të organizatave dhe aktorëve që kontribuojnë në debatin publik si mbikëqyrës shoqërorë dhe të aksesit në informacionin e mbajtur nga organet publike. Këto vendime nuk nënkuptojnë një të drejtë të pakufizuar për çdo dokument, por kërkojnë që kufizimet të jenë të ligjshme, të arsyetuara dhe të vlerësuara në kontekst.

Në rastin konkret, informacioni lidhet me vendimmarrje për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, dokumente që kanë të bëjnë me një projekt të identifikuar publikisht dhe me një zonë të ndjeshme mjedisore. Kjo rrethanë e përforcon interesin publik për akses, pa përjashtuar analizën e kufizimeve të ligjshme dhe përdorimin e anonimizimit aty ku është i nevojshëm. Në çdo rast, vendimi administrativ duhet të jetë i individualizuar, i arsyetuar dhe i mbështetur në faktet e provuara. Autoriteti nuk mund të mjaftohet me deklarime të përgjithshme se dokumentet nuk janë në fuqi apo nuk janë zbardhur, por duhet të shpjegojë për secilin dokument, nëse e disponon, çfarë pjese është e aksesueshme, cilin kufizim zbaton dhe pse nuk mund të përdoret një masë më pak kufizuese.

Për sa më sipër, Komisioneri çmon se përgjigjet e AZHT-së, ndonëse konfirmojnë ekzistencën e të dhënave që identifikojnë informacionin e kërkuar, nuk i kanë siguruar ankuesit të drejtën për informim sipas objektit të kërkesave të tij. Për rrjedhojë, argumentet e Autoritetit Publik mbi statusin juridik të vendimeve dhe procesit të "zbardhjes", pa sqaruar konkretisht nëse ato janë konfirmuar e regjistruar sipas përkufizimit të dhënë nga LDI për informacionin publik, nuk përbëjnë, në vetvete, shkak të mjaftueshëm për refuzim dhe, si të tilla, gjenden të pabazuara.

Sa i takon kërkesës për kopjen e projektit "*Zvërnec Peninsula - Kompleks multifunksional, banimi, shërbimesh, hotelerie, rekreacion, marina, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 kate, me vendndodhje në Zvërnec, Bashkia Vlorë", me subjekt zhvillues shoqërinë "Zvërnec South Adriatic Development" sh.p.k.*", ndonëse nga Autoriteti Publik nuk është kthyer përgjigje, rezulton se në lidhje me këtë projekt janë publike disa informacione në portalin "Flamingo Mirror/Pasqyra e Flamingos". Konkretisht, në rubrikën "Pyetje"[4] të këtij portali rezulton

[2] *Kërkesa nr. 18030/11, vendim i datës 08.11.2016.*
[3] *Kërkesa nr. 48135/06, vendim i datës 25.06.2013.*
[4] https://flamingomirror.al/dosje/sazani-dhe-zverneci/pyetje

se janë dhënë disa përgjigje në lidhje me këtë projekt. Në njërën prej tyre referohet: *"Deri më tani për Zvërnecin janë miratuar: - Vendimi nr. 41, i datës 30.06.2026, KKTU, me leje zhvillimi vendosi kushte dhe kufizime konkrete për vijimin e projektit - Vendimi nr. 05, i datës 29.04.2026, KKTU, leje infrastrukture, me qëllim realizimin e rrugëkalimeve të nevojshme për vendosjen e pajisjeve të përkohshme në kuadër të hartimit të VNM-së - Vendimi për Realizim të Vlerësimit të Thelluar të Ndikimit në Mjedis, 15 maj 2026".*

Ndërkohë, në pjesët e procesverbaleve të mbledhjeve, të datave 30.06.2026 dhe 29.04.2026, që lidhen me projektin për të cilin ka kërkuar informacion ankuesi, është shënuar "*Subjekti bën prezantimin e projektit të ilustruar në slideshow*".

Sa më sipër, AZHT, si sekretariati teknik i KKTU-së, disponon informacion mbi projektin e kërkuar, duke qenë se ai është pjesë e të gjitha dosjeve të aplikimit të paraqitura nga subjekti zhvillues, si dhe është prezantuar në mbledhjet e sipërcituara. Për rrjedhojë, duhet të vlerësohet dokumentacioni që Autoriteti Publik administron konkretisht, pa paragjykuar disponimin e projektit të plotë në formën e kërkuar nga ankuesi.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se dokumentacioni i kërkuar mbi dosjet e paraqitura nga subjekti zhvillues dhe projektin përbën informacion publik, bazuar në pikën 2 të nenit 2 të LDI-së. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm, pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: *"Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".*

Në përfundim, Komisioneri çmon të nënvizojë se e drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dyja palëve.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjat "b" dhe "ç" të pikës 5 të nenit 24, nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar, si dhe shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar, Komisioneri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e ankesave nr. 1852 prot., datë 03.07.2026, nr. 1850 prot., datë 03.07.2026 dhe nr. 2129 prot., datë 29.07.2026, të z. , ndaj Autoritetit Publik "Agjencia e Zhvillimit të Territorit".

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik "Agjencia e Zhvillimit të Territorit" për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit, konkretisht: *kopjen e plotë të procesverbalit të mbledhjes së KKTU-së, të datës 29.04.2026; kopjet e vendimeve të*

identifikuara në kërkesën e datës 15.06.2026 dhe dokumentacionin përkatës të dosjes së projektit "Zvërnec Peninsula", përfshirë deklaratën/kërkesën për tërheqje nga aplikimi; kopjen e projektit "Zvërnec Peninsula – Kompleks multifunksional (...), të kërkuar më 14.07.2026, si dhe dokumentet shoqëruese që administrohen nga AZHT dhe përfshihen në objektin e kërkesës, brenda datës 02.11.2026, në përputhje me parashikimet e pikës 6 të nenit 17 dhe pikës 6/1 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 26.10.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi